

**VENDIM**  
**Nr. 651, datë 22.11.2023**

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHETËRORE “REGJISTRI I TË DHËNAVE TË TË DREJTAVE TË AUTORIT DHE TË DREJTAVE TË TJERA TË LIDHURA ME TO” DHE PËRCAKTIMIN E ELEMENTEVE TË REGJISTRIT TË TË DHËNAVE TË HAPURA PËR PUBLIKUN, DOKUMENTAR DHE ELEKTRONIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 157, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Qëllimi i këtij vendimi është krijimi dhe administrimi i bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri i të dhënave të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to” dhe përcaktimi i elementeve të regjistrit të të dhënave të hapura për publikun, dokumentar dhe elektronik (në vijim, baza e të dhënave).

2. Në këtë vendim, termat “baza e të dhënave shtetërore”, “subjekt i interesuar”, “dhënësi i informacionit”, “institucioni administrues”, “ndërveprimi”, “të dhëna parësore dhe dytësore” kanë të njëjtin kuptim siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

3. Institucioni administrues i bazës së të dhënave është Drejtoria për të Drejtën e Autorit.

4. Baza e të dhënave është në formë dokumentare dhe elektronike.

5. Baza e të dhënave përmban të dhënat parësore e dytësore.

6. Të dhëna parësore të hapura për publikun janë:

a) regjistrimi vullnetar i krijimeve të mbrojtura nga e drejta e autorit:

i. titulli i veprës;

ii. përshkrimi i veprës;

iii. numri i regjistrimit (RDA);

iv. data e regjistrimit;

v. kategoria e veprës.

b) regjistrimi i kalimit të të drejtave të autorit:

i. titulli i veprës;

ii. përshkrimi i veprës;

iii. numri i regjistrimit (RDA);

iv. data e regjistrimit;

v. kategoria e veprës;

vi. vlefshmëria e certifikatës së regjistrimit të kalimit të së drejtës;

vii. përkthyesi.

7. Të dhënat dytësore të hapura për publikun, janë:

a) veprat në domen publik:

i. institucioni që administron veprën;

ii. kategoria e veprës;

iii. autori, bashkautori, mbajtësi i së drejtës;

iv. data e daljes në domen publik.

b) agjencitë e administrimit kolektiv:

- i. emërtimi;
- ii. të dhëna kontakti;
- iii. statuti;
- iv. kategoria e përfaqësimit;
- v. vlefshmëria;
- vi. përbërja e bordit drejtues të Agjencisë së Administrimit Kolektiv;
- vii. lista e anëtarëve;
- viii. lista e veprave;
- ix. lista e marrëveshjeve të reciprocitetit;
- x. të dhëna financiare.

c) subjektet përdoruese dhe pajisja me autorizim për përdorimin e të drejtës së autorit:

- i. listë e subjekteve përdoruese të së drejtës së autorit;
- ii. listë e subjekteve të informuara pa u pajisur me autorizim;
- iii. listë e subjekteve të pajisura me autorizim;
- iv. vlefshmëria e autorizimeve.

ç) veprat pa autor:

i. Vepra pa autor:

- titulli i veprës;
- të dhëna identifikuese (nëse ka);
- përshkrim i veprës;
- kategoria e veprës;
- institucioni kompetent që e administron.
- ii. institucioni kompetent që e administron:
- të dhëna për kërkimin shterues;
- përdorimi i veprës;
- kohëzgjatja e përdorimit të veprës.
- iii. autori, bashkautori, mbajtësi i së drejtës:

- statusi aktual - anonim; emri i panjohur; i njohur, por me vendndodhje të paidentifikuar; asnjë informacion);

- lloji i autorësisë – autor; bashkautor; mbajtës i së drejtës.

iv. informacion për publikimin e veprës:

- publikimi, transmetimi, vendi i prodhimit;
- datat e publikimit;
- të dhënat e publikuesve;
- gjuha e publikimit.

v. imazhet shoqëruese.

8. Të dhëna dytësore të mbyllura për publikun, që merren nga një bazë tjetër të dhënash, ku ato janë parësore, janë:

a) të dhëna nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, si: numri personal, atësia, vendlindja, datëlindja, gjinia, bashkia, njësia administrative dhe adresa;

b) të dhëna nga Regjistri Tregtar, administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS), bashkia, njësia administrative, si dhe adresa ku ushtron aktivitetin profesional: numri, rruga, qyteti;

c) nga çdo bazë tjetër të dhënash, që mund të ndërveprojë me regjistrin e të dhënave të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, bazuar në vendimet dhe kuadrin rregullues përkatës.

9. Dhënës të informacionit për bazën e të dhënave janë:

- a) institucionet arsimore;
- b) sporteli unik për kryerjen e funksionit të mbledhjes së shpërblimeve të së drejtës së autorit;
- c) agjencitë e administrimit kolektiv të të drejtave të autorit;
- ç) biblioteka publike shtetërore;
- d) biblioteka publike private;
- dh) muzetë në Republikën e Shqipërisë;
- e) institucionet e ndryshme arkivkrijuese, që zbatojnë dispozitat e depozitimit të detyrueshëm të kopjeve të ligjshme të krijimeve, të publikuara, të prodhuara ose të importuara në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) institucionet arkivore filmike ose audiovizuale;
- f) transmetuesit publikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

10. Subjektet e interesuara për bazën e të dhënave janë, si më poshtë vijon:

- a) Institucionet e administratës publike;
- b) Sporteli unik për kryerjen e funksionit të mbledhjes së shpërblimeve të së drejtës së autorit;
- c) Agjencitë e administrimit kolektiv;
- ç) Organizmat ndërkombëtarë që funksionojnë brenda dhe jashtë Shqipërisë;
- d) Çdo individ, person tjetër fizik ose juridik.

11. Niveli dhe mënyra e aksesit në sistem e subjekteve të interesuara është, si më poshtë vijon:

a) Si konsultues (*viewer*) të informacionit nëpërmjet *web*-it:

- i. institucionet e administratës publike;
- ii. institucionet arsimore;
- iii. subjektet e sistemit të menaxhimit kolektiv;
- iv. përfaqësuesit e autorizuar;
- v. çdo individ, person fizik ose juridik.

b) Si administrator, përpunues dhe përditësues i bazës së të dhënave është Drejtoria për të Drejtën e Autorit;

c) Individët, personat fizikë ose juridikë, të cilët regjistrojnë vullnetarisht krijimet e mbrojtura nga e drejta e autorit ose kalimin e të drejtave kanë akses të kufizuar në bazën e të dhënave, që i lejon të tërheqin kopje të certifikatës së regjistrimit të së drejtës së autorit dhe të kalimit të të drejtave. Çdo individ, person fizik ose juridik, paraqet kërkesë në ministrinë përgjegjëse për të drejtën e autorit për t'u pajisur me akses të kufizuar.

12. Të dhënat personale të përfshira në bazën e të dhënave përpunohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar. Ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit përdor bazën e të dhënave edhe për përpunimin e statistikave, kërkimeve, studimeve dhe analizave të të dhënave, si dhe për komunikimin ose shpërndarjen e mundshme të tyre, vetëm në formë anonime, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

13. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën e bazës së të dhënave, në varësi të nevojave dhe të informacionit të institucionit, dhe përshtatjen me praktikën evropiane e ndërkombëtare në fushën e të drejtës së autorit bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

14. Ministri përgjegjës për të drejtën e autorit miraton rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri i të dhënave të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to", në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

15. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**